



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 14.10.2024

Më datë 14 Tetor u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Puna e kryer nga INSTAT dhe KKN mbi Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike të rishikuara NVE Rev. 2.1;
2. Hapat për finalizimin e miratimit të NVE Rev 2.1;
3. Çështje të tjera.

Nën-kryetarja e KKN, Znj. Rahela Reçi hapi takimin dhe bëri prezantimin e rendit të ditës i cili u miratua pa ndryshime nga anëtarët. Takimi vijoi sipas axhendës.

Puna e kryer nga INSTAT dhe KKN mbi Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike të rishikuar NVE Rev 2.1 si dhe hapat për finalizimin e dokumentit final të nomenklaturës.

Znj. Flutura Rama, bëri një përmbledhje të punës së kryer në kuadër të finalizimit të dokumentit në gjuhën shqipe të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev 2.1. Ndër të tjera ajo referoi që nga EUROSTAT janë siguruar të gjitha dokumentat finale (regullorja, nota shpjeguese si dhe tabela e korrespondencës). Tabela e korrespondencës është një dokument tejet i rëndësishëm për të siguruar vazhdimësinë dhe historikun e njësive ekonomike të cilat klasifikohen me këtë klasifikim.

Znj. Rama shtoi që nota shpjeguese e nomenklaturës së NVE Rev 2.1 është përkthyer në gjuhën shqipe nga ekspertë të fushës në INSTAT si dhe ka kaluar për rishikim tek anëtarë e KKN-së. Nomenklatura është pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe nevojitet të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda 3- muorit të parë të vitit 2025.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Të gjitha dokumentat që kanë një bazë ligjore ose një rregullore evropiane duhet të përkthehen nga përkthyes të çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë. Vitet e kaluara jemi ndeshur me vonesa në lidhje me përkthyesit, pasi numri i rregulloreve ka qenë shumë i lartë. Për këtë arsye, INSTAT mori një iniciativë të veten duke e përkthyer nomenklaturën NVE Rev 2.1 nga staf i brendshëm i INSTAT. Gjatë kohës që ky dokument ju kalua anëtarëve të KKN-së për komente, erdhi dhe nomenklatura e përkthyer nga përkthyesi i çertifikuar.

Pas krahasimit të dy dokumentave (përkthimi nga stafi i INSTAT si dhe ai i përkthyesit të çertifikuar) u vunë re disa ndryshime. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Znj. Elsa Dhuli (e cila ka dhe rolin e kryetarit të KKN-së) propozoi që për të arritur në një dokument final nevojitet dhe një herë mbështetja e Ministrive të cilat kanë përfaqësues në KKN.

Përkthimi nga përkthyesi i çertifikuar është cilësor mirëpo në shumë raste u ndeshën terminologji të cilat nuk janë shprehur në mënyrën adekuate. Si rrjedhojë për të mbërritur në një dokument final është përgatitur një material në format Excel në të cilin janë vendosur 3 versione:

- Versioni anglisht EUROSTAT;
- Versioni shqip (punuar nga stafi i brendshëm INSTAT me kontribut të veçantë nga anëtarët e KKN-së);
- Versioni nga përkthyesi i çertifikuar.

Dokumenti në format Excel është ndarë në seksione dhe çdo seksioni i është atashuar sektori përgjegjës në INSTAT si dhe Ministria përkatëse. Nevojitet një bashkëpunim dy palësh për të përcaktuar terminologjinë e saktë e për të pasur në vijim një nomenklaturë cilësore në gjuhën shqipe e cila gjithashtu do vijë në formatin libër e do jetë në përdorim për 10 vitet e ardhshme.

Znj. Reçi propozoi që anëtarët e KKN-së të diskutojnë paraprakisht në Institucionet e tyre me personat përgjegjës të cilët janë ekspertë në fusha të ndryshme e që mund të ofrojnë kontributin e tyre në përcaktimin e sakt të terminologjisë.

Prezenca e përfaqësuesit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në takimin e radhës.

Në vijim takimi u fokusua në rolin e AKSHI-t në procesin e implementimit të NVE Rev. 2.1. Cdo ndryshim ose ndërhyrje që kryhet në kuadër të rishikimit të një nomenklature nga ana e AKSHI-t

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

njihet si zhvillim pra e thënë ndryshe institucionet janë vendim-marrëse ndërkohë që AKSHI është implementues i ndryshimeve që ndodhin në sistem.

Gjatë muajit Shtator përfaqësues nga INSTAT zhvilluan një takim me përfaqësues nga AKSHI në mënyrë që ti shpjegohej puna që po kryhet në kuadër të rishikimit të NVE Rev. 2.1.

Z. Maldi Dema propozoi gjatë takimit që fillimisht të unifikohet matëriali ndërmjet institucioneve të cilët janë pjesë e KKN dhe më pas AKSHI të përfshihet në proces.

Në përfundim anëtarët dakordësuan që përfaqësuesi nga AKSHI të jetë pjesë e takimit pasi të jetë marrë vendimi dhe të ketë përfunduar përkthimi, pra të unifikohet matëriali e më tej të diskutohet implementimi në sisteme.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN
22 Tetor 2024

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al